



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0009467-1/26 dt. 27.02.2026

Mitrovicë

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa
Mbledhja e 2-të

Koha: 27.02.2026 ora 10:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Majlinda Kurti, Igballe Islami, Valon Brahimi, Erseka Barani, Kushtrim Zeneli dhe Visar Syla

Anëtarët e Bordit të Drejtorëve

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Safet Kamberi i cili theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11, të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot kam thirrur mbledhjen e dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa me këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Propozim vendim për formimin e komiteteve konsultative
3. Propozim vendim për zgjedhjen e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës për anëtarë të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës
4. Raporti financiar i komunës për realizimin e buxhetit komunal janar - dhjetor 2025

Në vazhdim Kryesuesi i mbledhjes hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Valon Brahimi: Në mbledhjen e kaluar jemi dakorduar që për këtë mbledhje në rend dite të hyjë pika: Propozim vendim për miratim të vendimit paraprak për publikim të listës së përgjithshme të pronave të paluajtshme të komunës si dhe listën e veçantë të pronave të cilat planifikohen për dhënie në shfrytëzim gjatë vitit 2026. Më intereson të dijë pse nuk e kemi sot këtë pikë për shqyrtim.

Kryesuesi Safet Kamberi: Në fillim të muajit mars do ta kemi mbledhjen e radhës së Komitetit për Politikë dhe Financa, ku në rend dite do të jetë kjo pikë, ndërsa mbledhja e Kuvendit do të mbahet pastaj me pikat e dala nga dy mbledhjet e KPF-së.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës të paraparë me thirrje.

Rendi i ditës u miratua unanimitisht (7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime).

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e parë e KPF-së u miratua unanimitisht (7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime).

Pika 2

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për formimin e komiteteve konsultative.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për formimin e komiteteve konsultative.

Rezultati i votimit: 6-për, 0-kundër, 0-abstenime.

Propozim-vendimi për formimin e komiteteve konsultative u miratua me shumicë votash dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 3

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për zgjedhjen e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës për anëtarë të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Propozim-vendimin për zgjedhjen e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës për anëtarë të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Propozim-vendimi për zgjedhjen e përfaqësuesve të Kuvendit të Komunës për anëtarë të Kuvendit të Asociacionit të Komunave të Kosovës u miratua unanimitisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 4

Kryesuesi i mbledhjes Safet Kamberi hapi diskutimin lidhur me Raportin financiar të Komunës për realizimin e buxhetit komunal janar - dhjetor 2025.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim, Kryesuesi vuri në votim Raportin financiar të Komunës për realizimin e buxhetit komunal janar - dhjetor 2025.

Rezultati i votimit: 7 për, 0 kundër dhe 0 abstenime.

Raporti financiar i Komunës për realizimin e buxhetit komunal janar - dhjetor 2025 u miratua unanimitisht dhe i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 10:20 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:


Merita PRETENI



Kryesuesi i Kuvendit


Safet KAMBERI